

# Styria (Steiermark) vaksinon!

## **PSE DUHET VETË TË VAKSINOHENI?**

Vaksinimi ju mbron që të mos sëmureni rëndë me COVID-19 dhe zvogëlon rrezikun e infektimit të të tjerëve.

## **SI FUNKSIONON VAKSINIMI?**

Nëpërmjet vaksinimit trupi pranon informatën që të krijoj antitrupa. Këta antitrupa e mbrojnë trupin nga të sëmurit rëndë me COVID-19. Të gjitha vaksinat nuk përmbajnë virus (SARS-CoV-2).

## **A ËSHTË VAKSINIMI I SIGURT?**

Po. Vaksina është testuar për siguri. Agjencia Evropiane e Barnave (EMA) e ka dhënë miratimin. Vaksina është gjithashtu e sigurt edhe për personat me diabet, tension të lartë, sëmundje të zembrës dhe astmë.

## **SI TË MERRNI NJË TERMIN PËR VAKSINIM?**

Vaksinimin e juaj kundër Coronës mund t'a bëni në rrugët e vaskinimit të Styria-së – steirischen Impfstraßen-, si dhe në ordinancat e shumëta të vaksinimit të mjekëve rezidentë. Aktualisht nuk kërkohet regjistrim në rrugët e vaksinimit (Impfstraßen) të Styrias.

## [LINKU PËR ORARIN E PUNËS](#)

## [LINKU PËR PASQYRËN E RRUGËVE TË VAKSINIMIT TË VENDIT \(IMPFSTRAßEN DES LANDES\).](#)

Ju lutemi sillni me vete dokumentet e mëposhtme në takimin për vaksinim:

- ✓ Konfirmimin e regjistrimit të shtypur ose dixhital
- ✓ e-Card-ën e juaj valide
- ✓ Librezën- kartelën e juaj të vaksinimit (nëse e keni në dispozicion)
- ✓ Listën aktuale të medikamenteve (nëse ka)
- ✓ [Aufklärungs- und Dokumentationsbogen zur Corona-Schutzimpfung](#) – të plotësuar (Fletëinformacion-sqarimin dhe Pyetësorin e kompletuar për vaksinim nga Corona me vaksinë) – të plotësuar.

## **SA VAKSINA DUHET T'I MERRNI?**

Komiteti Kombëtar i Vaksinimit rekomandon gjithsejt 3 vaksinime për të gjitha personat nga moshë 5 vjeçare e më lartë për mbrojtjen më të mirë të mundshme dhe afatgjate të vaksinimit: 2 vaksinime për serinë e parë të vaksinimit plus një vaksinim të mëtejshëm pas 6 muajve. Për personat mbi 80 vjeç, rekomandohet një vaksinim shtesë (vaksinimi i 4-të) në 4 muajt më të hershëm, por në çdo rast 6 muaj pas imunizimit bazë (vaksinimi i 3-të) (off-label). Personat e rrezikuar (pavarësisht nga moshë, prej 12 vjeç) dhe personat ndërmjet moshës 65 dhe 79 vjeçe me sëmundje dhe rrethana të mëparshme që paraqesin një rrezik të ngritur për një rrjedhshmëri të rëndë të Covid-19, respektivisht tek të cilët pritet kohëzgjatje më e shkurtër e mbrojtjes me vaksinim, duhet të marrin/duhet t'ju ipet më së pari që nga muaji i 4-të, e në mënyrë optimale nga muaji i 6-të pas imunizimit bazë (vaksinimit të 3-të) pas një vlerësimi mjekësor individual të përfitimit dhe rrezikut, një vaksinim shtesë (vaksinimi i 4-të) (off-label).

## **JU KENI ALERGJI. A MUNDENI MEGJITHATË TË VAKSINOHENI?**

Punonjësitë e kujdesit shëndetsor mund t'a kalojnë me ju listën e përmbajtjes së vaksinës, për tu siguruar që mund t'a bëni vaksinimin. Vaksina COVID-19 nuk përmban vezë, xhelatinë, mjete konservuese ose antibiotikë.

## **JU KENI QENË I/E SËMURË ME COVID-19. A KENI AKOMA NEVOJË PËR VAKSINIM?**

Po. Imuniteti pas një lëngimi nga sëmundja me COVID-19 ju mbron për një kohë të caktuar. Ju mund prapë të sëmuheni me COVID-19. Është më mirë të vaksinoheni për të qëndruar të mbrojtur dhe për të zvogëluar rrezikun e infektimit të të tjerëve.

### **A KA EFEKTE ANËSORE NGA VAKSINIMI?**

Mund të ketë efekte anësore: dhimbje ose skuqje në vendin e injeksionit, si dhe kokëdhembje, ethe dhe shtrëngime të muskujve. Këto reagime janë mjaft të zakonshme, por janë reagime normale. Këto reagime kalojnë në të shumtën e rasteve brenda pak ditëve. Pas vaksinimit, ju do të vëzhgoheni nga personeli mjekësor për rreth 15 minuta.

### **A ËSHTË VAKSINIMI VULLNETAR?**

Që nga shkurti 2022 ekziston një kërkesë e përgjithshme për vaksinim të detyrueshëm kundër Covid 19. Me vaksinimin kundër koronës ju mund të mbron veten dhe të tjerët përreth jush në mënyrën më të mirë të mundshme.

### **A KENI NDONJË PYETJE LIDHUR ME VAKSINIMIN KUNDËR CORONËS DHE VAKSINËN?**

Kontakttoni telefonin federal të informacionit: 0800 555 621

Të gjitha informatat për Styria vaksinon „Steiermark impft“ : [www.impfen.steiermark.at](http://www.impfen.steiermark.at)

Regjistrimi paraprak për vaksinim: [www.steiermarkimpft.at](http://www.steiermarkimpft.at)